



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 404/2025

Datë: 23.10.2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me 22 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenin 25 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, në mbështetje të nenit 44 dhe 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) – Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në bazë të kërkesës së datës 20.10.2025, Ushtruesi i detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për pushimin e shërbimit të noterit

1. Z. Egzon (Cenë) Lajqi i emëruar noter në territorin e Komunës së Prizrenit, me Vendimin nr. 219/2025, të datës 14.04.2025, i pushon ushtrimin i detyrës së noterit për shkak të dorëheqjes.
2. Shfuqizohet Vendimi nr. 219/2025, të datës 14.04.2025 për emërimin e Z. Egzon Lajqi në detyrën e noterit dhe Vendimi nr. 290/2025 i datës 27.05.2025 për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit.
3. Obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me Vendimin nr. 219/2025, të datës 14.04.2024, Z. Egzon Lajqi është emëruar në detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Prizrenit, ndërsa me Vendimin nr. 290/2025 të datës 27.05.2025 z. Lajqi është caktuar të filloj të ushtroj detyrën e noterit për territorin e Komunës së Prizrenit me datën 16.06.2025.

Më datën 20.10.2025, z. Lajqi, nëpërmjet e-mailit, në formë elektronike i është drejtuar Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë dhe ka paraqitur dorëheqjen nga ushtrimi i detyrës së noterit, me efekt nga data 21.10.2025, për shkak të arsyeve personale.

Andaj, meqë dorëheqja e tij është paraqitur në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në pajtim me neni 22 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenit 25 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Blerim Sallahu
Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi palët mund të iniciojnë konfliktin administrativ brenda afatit të përcaktuar ligjor në gjykatën kompetente.

Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Egzon Lajqi;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Gjykatës Themelore në Prizren;
- Odes së Noterëve të Kosovës;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika.
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.